



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 40 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare, të mbajtur më 16, 22 dhe 23 korrik 2015, pas debatit parlamentar lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së deputetes Albulena Haxhiu, mbështetur edhe nga pesë (5) deputetë tjerë, nxori këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e fton presidenten e Republikës, znj. Atifete Jahjaga, që t'i kërkojë Komisionares së Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të BE-së, znj. Frederica Mogherini, iniciimin e hetimit institucional për çdo rast të cituar për stafin e EULEX-it në raportin që zyrtarët e BE-së e kanë hartuar.
2. Të thërrasë në raportim të jashtëzakonshëm kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me aferat që kanë të bëjnë me ndikimin e çështjeve hetimore të zyrtarëve të EULEX-it dhe marrjes arbitrare të kompetencave të organeve të drejtësisë nga EULEX-i.
3. Raportimi i kryesuesve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës të bëhet dhjetë (10) ditë nga miratimi i kësaj rezolute.
4. Kjo rezolutë hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nr. 05-R-004

Prishtinë, më 23 korrik 2015

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Presidentes së Republikës së Kosovës,
- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
- Këshillit Prokurorial të Kosovës,
- Deputetes Albulena Haxhiu,
- Arkivit të Kuvendit.